



UNMIK



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETQEVERISJES  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE  
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE  
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE

Në përputhje me Nenin 1 pika 1.7 paragrafi d të Rregullores nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, me qëllim të funksionimit më efikas të strukturave organizative të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministri i MPMS-së nxjerr këtë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr.6/2003  
PËR THEMELIMIN E DEPARTAMENTIT TË  
ADMINISTRATËS PENSIONALE**

**Neni 1**

**1.1** Me këtë Udhëzim Administrativ, themelohet Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës (më tej DAPK), si Departament i veçantë në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

**Neni 2**

**2.1** Funkzioni dhe përgjegjësia e DAPK-së do të jetë Menaxhimi dhe Administrimi i pensioneve bazë dhe pensioneve të aftësisë së kufizuar.

Duke pasur parasysh këto përgjegjësi DAPK-ja është e obliguar që:

- Të krijojë dhe përcaktojë politikat e zhvillimit të sistemit pensional, sipas rregullave juridike të aplikueshme në Kosovë.
- T'ua rregullojë pagesën e pensioneve bazë përsonave që i plotësojnë kriteret sipas Rregullores nr.2001/35
- T'ua rregullojë pagesën e pensioneve të aftësisë së kufizuar, përsonave që i plotësojnë kriteret sipas Ligjit për Pensionet e Aftësisë së Kufizuar në Kosovë.
- Të mbajë saktësisht evidencën e faturave dhe të mjeteve financiare, për pagesat e pensioneve bazë dhe pensioneve të aftësisë së kufizuar.
- Të mbajë regjistrin dhe statistikën për të gjitha shpenzimet lidhur me shpërndarjen e pensioneve bazë dhe pensioneve të aftësisë së kufizuar.
- Të asistojë dhe administrojë në rregullimin e të drejtave në pensione për qytetarët e Kosovës që kanë fituar të drejtën e pensionit jashtë vendit.

- Të hulumtojë mundësitë e kthimit të mjeteve të fondit për pensionistët kosovarë, duke u bazuar në konventat ndërkombëtare dhe ligjet e aplikueshme të Kosovës nga fusha e sigurimit social.
- Të ndërmarrë edhe të gjitha aktivitetet e tjera për përparimin edhe zhvillimin e sistemit pensional në Kosovë.

### **Neni 3**

- 3.1** Me punën dhe aktivitetet e DAPK-së udhëheq Drejtori i Departamentit të Administratës Pensionale
- 3.2** Për punën e DAPK-së, Drejtori i raporton Se kretarit të Përhershëm të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies sociale.

### **Neni 4**

- 4.1** Deri në miratimin e Rregullorës për organizimin e punës në MPMS, Drejtori i DAPK-së në konsultim me Sekretarin e Përhershëm të MPMS-së do të vendosë për organizimin dhe strukturimin e DAPK-së si në principin funksional ashtu edhe në principin territorial.

### **Neni 5**

- 5.1** Ministri dhe Sekretari i Përheshëm i MPMS-së, mund të nxjerrin rregulla të tjera juridike për zhvillimin e punës së DAPK-së.

### **Neni 6**

- 6.1.** Drejtori i DAPK-së dhe stafi tjetër menaxhues do të rekrutohen me konkurs. Procesi i rekrutimit do të jetë konkurues, i drejtë dhe në bazë të meritave, siç është përcaktuar në Rregulloren 2001/36 për Shërbimin Civil në Kosovë

### **Neni 7**

- 7.1** Ky Udhëzim Administrativ, do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i MPMS-së.

**Prishtinë, Janar 2004**

**Ministri i MPMS-së  
Ahmet Isufi**

---